



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË  
TEPELENË

Nr.1917/5.prot.

Tepelenë më, 01 . 09. 2022



**V E N D I M**  
**Nr.69.Datë.31.08.2022**

**“Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënien në përdorim të fondit kullor ndodhur në Bashkinë Tepelenë me qëllim studimin mbi potencialin e energjise së erës”**

Në mbështetje të nenit 8 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor” dhe të nenit 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, ligjit nr.139/2015 “Per vetqeverisjen vendore”; ligjit 115/2014 “Per ndarjen administrative territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar; ligjit nr.9743 date 22.02.2001 “Per pronat e paluajtshme te shtetit”; Udhezimit nr.1 date 9.6.2016 te Ministrit te Mjedisit “Per rregullat e procedurat e kerkimit, shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor dhe kullor publik”; shprehjes se interesit te subjektit “E U GREEN ENERGY” Shpk nr.55 dhe 56 date 31.5.2022 protokolluar prane bashkise me nr.1236 dhe nr.1237 date 31.05.2022; mbështetur në të dhënat e inventarit të Bashkise Tepelene rezulton që sipërfaqja bënë pjesë në inventarin e Bashkise Tepelene përkatësisht të njësive administrative Kurvelesh dhe Qendër;

**V E N D O S I:**

1. Të jape pëlqimin në parim për dhënien me qira për pasuritë si më poshtë, sipas funksionit dhe destinacionit që kanë:
  - Pasuritë me nr.514, përkatësisht parcela nr.29 të Ekonomisë Kullor Dukaj-Luzat, ZK 3661, fshati Turan, lloji i pasurisë “Kullotë” në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas inventarit të Bashkisë Tepelenë me VKM nr.433/2016 të ndryshuar.
  - Parcelat nr. 10 të Ekonomisë Kullor Kurrevelesh, fshati Lekdush, lloji i pasurisë “Kullotë” në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas inventarit të Bashkisë Tepelene me VKM nr.433/2016 të ndryshuar.

Të dhënat e tokave bujqësore sipas tabelës së mëposhme:

Nr	Njësia administrative/fshati	Zona kadastrale	Nr pasurie	Nr. Parcele	Sipërfaqe m <sup>2</sup>
1	Kurvelesh/ Lekdush	2404		10	2000

Nr	Njësia administrative/fshati	Zona kadastrale	Nr pasurie	Nr. Parcele	Sipërfaqe m <sup>2</sup>
1	Qendër/ Turan	3661	514	29	2000

2. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit publik dhe elementeve të tij, në mbështetje të Udhëzimit nr. 1, datë 6.6.2016 të Ministrit të Mjedisit “Per rregullat e procedurat e kerkimit, shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor dhe kullor publik” si dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për administrimin e fondit kullor/pyjor.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e korrespondencës, plotësimin e dokumentacionit si dhe për kryerjen e procedurave të mëtejshme në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit nr. 1, datë 6.6.2016 të Ministrit të Mjedisit “Per rregullat e procedurat e kerkimit, shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor dhe kullor publik”, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Komisioni i Qiradhënies së Pyjeve e Kullotave publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

**KRYETAR**

**Elvis Shehu**

Sekretari I Këshillit Bashkiak

Valbona Çela

Miratuar me 12( dymbëdhjetë) vota

Vota Pro 12 ( dymbëdhjetë)

Vot a Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur më datë 01.09.2022